



DOKUMENT MBI POLITIKAT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE GJATË PROCESIT PENAL

QNL

Tiranë, 2025

DOKUMENT MBI POLITIKAT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE GJATË PROCESIT PENAL

*Ky dokument është përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadër të një nën-granti të dhënë nga **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)**, si pjesë e projektit “**Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane**”, mbështetur financiarisht nga **Bashkimi Evropian**.*

*Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij dokumenti i takon vetëm Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e **Bashkimit Evropian, KShH-së apo partnerëve të projektit**.*

HYRJE

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka monitoruar vendimet gjyqësore për veprat penale në lidhje me dhunën seksuale, dhunës ndaj të miturve dhe veprave të ngjashme, të parashikuara nga nenet 100–108/a dhe 121/a të Kodit Penal. Ky dokument Politikash hartohet mbi bazën e gjetjeve të Raportit të Monitorimit: VIKTIMA E KRIMEVE SEKSUALE NË KUADRIN E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR. *Gjetje nga monitorimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave të Shkallës së Parë, Lezhë e Sarandë (2020–2024).*¹

Ndër objektivat kryesore të Dokumentit të politikave janë: përmirësimi i dhënies së drejtësisë dhe rritja e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve, profesionistëve të së drejtës mbi një drejtësi cilësore të orientuar drejt mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale.

Analizimi i vendimeve gjyqësore për rastet e dhunës seksuale ndihmon për të kuptuar nëse ligji zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme, nëse viktimat arrijnë të marrin drejtësi apo përballen me pengesa (vonesa, mosbesim, viktimizim të dytë), se si gjykatat interpretojnë konceptet kyçe ligjore, si pëlqimi, rezistenca, pendimi, pajtimi, detyrimi apo besueshmëria e dëshmisë së viktimës. Analiza ndihmon të evidentohen raste që ngrenë dyshime kur mbledhja apo interpretimi i provave ka qenë i pamjaftueshëm, kur rrethanat lehtësuese dobësojnë mbrojtjen e viktimës, kur normat e dënimit janë të ulëta ose ka marrëveshje për pranimin e fajësisë, kur shërbimet mbështetëse nuk i përgjigjen situatës komplekse në të cilën ndodhet viktimja e krimeve seksuale, veçanërisht kur është i/e mitur.

Përmes analizës së vendimeve gjyqësore janë identifikuar praktikat e mira dhe problematikat në lidhje me mungesën e ndjeshmërisë gjinore, mungesën e referimit apo zbatimit të standardeve ndërkombëtare (GJEDNJ, CEDAW, jurisprudenca ndërkombëtare penale). Është konstatuar edhe mungesa e unifikimit të praktikës gjyqësore.

Analiza e rezultateve ndihmon të vlerësohet niveli i garancive dhe mbrojtjes së të drejtave të viktimës dhe shmangia e viktimizimit të dytë. Ky synim arrihet duke shqyrtuar nëse viktimat trajtohen me dinjitet dhe respekt gjatë gjithë procesit, nëse mbrohet jeta e tyre private, siguria dhe integriteti psikologjik dhe, nëse mekanizmat e drejtësisë fuqizojnë apo ri-traumatizojnë viktimat. Trajtimi i papërshtatshëm i rasteve të dhunës seksuale nga gjykatat mund të përbëjë vetë një formë diskriminimi.

¹ Shih: https://www.qag-al.org/publikime/raport_viktima_krimeve_seksuale.pdf

Një analizë sistematike e rezultateve ndihmon edhe për të forcuar llogaridhënien e institucioneve përgjegjëse. Kjo do të kërkonte që policia, prokuroria, gjykatat, institucione të tjera në nivel qendror dhe vendor apo edhe organizatat e shoqërisë civile të bashkëpunojnë në mënyrë efektive, për përmirësimin e qasjes miqësore të drejtësisë me viktimat, të transparencës dhe rritjes së besimit publik në institucionet e drejtësisë.

I. QËLLIMI DHE OBJEKTI I DOKUMENTIT TË POLITIKAVE

QNL dhe organizatat partnere “Gruaja tek Gruaja” dhe “Jona”, synojnë që nëpërmjet hartimit të këtij dokumenti politikash, të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së drejtësisë dhe respektimin e të drejtave të viktimave të dhunës seksuale, në përputhje me kërkesat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të veçantë, synohet përmbushja e të drejtave për informim, mbrojtje dhe mbështetje; harmonizimi i legjislacionit dhe praktikave gjyqësore me standardet e sanksionuara në konventat ndërkombëtare dhe direktivën e Bashkimit Evropian 2012/29/EU; përdorimi i rekomandimeve dhe gjetjeve kryesore të raportit të monitorimit të vendimeve gjyqësore për hartimin e politikave të institucioneve të drejtësisë në Shqipëri, si dhe përmirësimi afatgjatë i praktikave gjyqësore përmes integritit të rekomandimeve në punën e gjyqtarëve dhe institucioneve.

Dokumenti ka objekt hartimin e disa treguesve të rëndësishëm dhe sugjerimeve për dhënien e drejtësisë, sidomos:

- Për standardizimin e praktikave dhe të vendimeve gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale në procesin penal.
- Për standardizimin e praktikave në lidhje me informimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale në procesin penal.
- Për përmirësimin e mbajtjes së të dhënave dhe statistikave për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale në procesin penal.

II. BAZA LIGJORE.

Ky dokument bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (nenet 3, 15, 42), në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (nenet 100 - 108/a dhe 121/a); në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”; në ligjin nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti”.

Dokumenti bazohet në aktet ndërkombëtare si vijon: në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit), në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të gjitha Formave

të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW-t), si dhe në Direktivën 2012/29/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të 25 tetorit 2012, për vendosjen e standardeve bazë (minimum) të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit.

III. SUBJEKTET INSTITUCIONALE.

Ky dokument u drejtohet institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si vijon:

Institucione Kushtetuese

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor,
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë,
3. Prokurori i Përgjithshëm.

Institucione të tjera:

1. Ministri i Drejtësisë
2. Shkolla së Magjistraturës

Një vëmendje të posaçme dokumenti e drejton ndaj gjyqtarëve e prokurorëve që punojnë në këtë fushë.

IV. GJETJE NGA MONITORIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE.

Analiza e 88 vendimeve gjyqësore tregon se rasti më i shpeshtë i krimeve seksuale është vepra Penale “Ngacmimi seksual” (Neni 108 i Kodit Penal). Në shumicën e rasteve numri i viktimave është 1 viktimë (92%). Shumica dërmuese e çështjeve të analizuara përfshijnë viktima femra (85%) dhe në rreth 67% të rasteve viktimat janë vajza të mitura. Analiza e të dhënave mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore pjesë e këtij monitorimi, tregon se shumica dërmuese e çështjeve janë trajtuar brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në më shumë se 80% të vendimeve të analizuara, gjykatat kanë kryer një arsyetim të qartë dhe të mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ka disa praktika pozitive, jo vetëm pranë Gjykatës së Apelit, por edhe në gjykatat e shkallës së parë, të cilat janë paraqitur në raportin e monitorimit të vendimeve gjyqësore.

Në vijim, përmbledhtazi janë paraqitur disa nga problemet e evidentuara.

Gjetjet e monitorimit tregojnë se, ndërkohë që 88% e të pandehurve kanë qenë të përfaqësuar nga avokatë, vetëm 38% e viktimave kanë pasur mbrojtës ligjorë gjatë procesit. Në 84% të vendimeve të monitoruara, identiteti i viktimës mund të kuptohet, përmes referencave ndaj vendbanimit, lidhjeve familjare, moshës së saktë apo elementeve të kontekstit social. Në 97% të vendimeve mungon çdo referencë për informimin e viktimës mbi të drejtat e saj procedurale, si dhe nëse ajo

është njoftuar për të drejtën për përfaqësim. Viktima është pyetur si dëshmitare vetëm në 13% të rasteve. Administrimi i provave shkencore përmendet në vendim, në vetëm 59% të rasteve.

Në 24% të rasteve, vendimet përfundimtare të gjykatave kanë pasur një referim apo disa referime në standardet ndërkombëtare (vendime apo akte ndërkombëtare), ndërsa në pjesën më të madhe të tyre, 72%, nuk gjendet referenca të tilla në vendim. Instrumentet ndërkombëtare të referuara në vendime janë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Direktiva nr.2012/29 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Konventa e OKB “Për të drejtat e fëmijës”, Rekomandimi Nr. R (99_22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, paragrafi 1). U gjetën referenca edhe në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në një prej vendimeve ishte integruar edhe një vendim të Gjykatës së Kasacionit të Republikës Italiane, me vlerë ndihmuese për arsyetimin e vendimit.

Qëndrimet e gjykatave duket se nuk janë të unifikuara në lidhje me interpretimin e rrethanave lehtësuese e rënduese. Në një rast gjykata ka renditur si rrethanë lehtësuese faktin që *e mitura nuk ka pësuar dëme konkrete, të parikuperueshme në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e saj të përditshme (qoftë aspektin fizik, ashtu edhe psikologjik), provuar ky fakt me aktin e ekspertimit mjeko-ligjor*. Një qëndrim i tillë bie ndesh kryesisht me parashikimet e Konventës së Stambollit, sipas të cilave thelbi i veprës penale të dhunës seksuale është mungesa e pëlqimit të lirë dhe të vetëdijshëm, jo niveli i dëmit fizik apo psikologjik. Koncepti “*pendesë e të pandehurit*”, në disa raste është vlerësuar si rrethanë lehtësuese, ndërsa në disa raste të tjera (këto më të shumta në numër) gjykatat e kanë renditur si rrethanë rënduese.

Në asnjë nga vendimet gjyqësore të monitoruara nuk gjetëm të dhëna nëse viktimat ka paraqitur padi civile në procesin penal dhe nëse Gjykata ka marrë ndonjë vendim për këtë. Në raste të mëparshme, kemi konstatuar se edhe kur gjykata ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për veçimin e padisë civile, nuk e ka pasqyruar në vendimin përfundimtar.

Në asnjë nga vendimet nuk gjetëm të dhëna nëse gjykimi është zhvilluar me dyer të mbyllura. Ndërkohë që 67% e viktimave ishin fëmijë, nuk jemi në gjendje të kuptojmë nëse ka pasur edhe vendime për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura.

Në 85% të vendimeve të monitoruara nuk është përmendur fare forma e njoftimit për viktimat, ndërkohë që asnjë prej vendimeve të monitoruara nuk është shprehur nëse është kryer njoftimi i vendimit përfundimtar ose i formës së prerë të gjykatës, tek viktimat.

Ndërsa nga të gjitha vendimet e monitoruara, vetëm 6 prej tyre, ose 7% e vendimeve kanë dedikuar në arsyetim shërbimet e mbështetjes për viktimën, si dhe bashkëpunimin me institucionet që ofrojnë shërbime mbështetëse.

Gjetje të tjera janë parashtruar në raportin e sipërcituar.

V. TREGUES PËR STANDARDIZIMIN E PRAKTIKAVE INSTITUCIONALE DHE TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE NË PROCESIN PENAL.

Me qëllim krijimin e një praktike të unifikuar në procesin gjyqësor penal, veçanërisht të vendimeve gjyqësore, për të përmbushur standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor ndaj viktimës, mbetet detyrë e institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, si dhe institucioneve të tjera që bashkëpunojnë me to, të marrin masa për të standardizuar praktikën institucionale dhe gjyqësore.

Për sa më sipër, sugjerojmë sa vijon:

1. Standardizimi i vendimeve gjyqësore

Vendimet e gjykatave të përfshijnë një seksion të posaçëm ku të vlerësohen në mënyrë të ndarë:

- *Identiteti dhe të dhënat për viktimën.*
 - Standardizimi i gjeneraliteteve për të pandehurin dhe viktimat.
 - *Anonimizim i plotë* i gjeneraliteteve të viktimave, kujdestarëve të viktimave të mitur apo personave në gjini me ta, fëmijëve, informacioneve lokalizuese dhe çdo personi dhe të dhëna që mund të identifikohet nga konteksti dhe të rrezikojë riviktimizimin.
 - Përjashtim nga publikimi i detajeve mjekësore, diagnozave ose përshkrimeve të ekspertimeve, përveçse kur janë absolutisht të domosdoshme për arsyetimin ligjor.
 - Balancim i barabartë i mbrojtjes së të dhënave midis viktimës dhe të pandehurit.
- *Raportimi i pasojave të dhunës seksuale ndaj viktimës.*
 - Pasojat fizike;
 - Pasojat psikologjike;
 - Pasojat sociale dhe ekonomike;
 - Ndikimi tek familja dhe komuniteti.
- *Raportimi në vendimin përfundimtar i vendimeve të ndërmjetme ose masave të ndërmarra.*
 - Gjykata duhet të shprehet në vendimin përfundimtar në lidhje me vendimet e ndërmjetme që ajo ka marrë gjatë procesit, p.sh.,:
 - zhvillimi i gjykimit me dyer të mbyllura,
 - vendime në lidhje me përfaqësimin e viktimës me avokat,
 - disponimi i padisë civile në procesin penal,

- rikualifikimi i veprës penale,
- forma e njoftimit të viktimës,
- detyrat për institucionet në lidhje me shërbimet e mbështetjes,
- vendime/masa për vlerësimin e pasojave të dhunës së ushtruar,
- vendime/masa për rehabilitimin e viktimës e të pandehurit.
- Vendime për kujdestarinë nëse ka, etj.
- Vendimi duhet të pasqyrojë edhe njoftimin e viktimës me vendimin përfundimtar, si dhe detyra për institucionet përgjegjëse për njoftimin dhe informimin e viktimës pas përfundimit të procesit penal.

- *Integrimi i ekspertizës ndërdisiplinare në vendim.*

- Gjykatat duhet të vlerësojnë gjatë arsytimit të vendimit raportet e ekspertëve si pjesë integrale të arsytimit për dënimin dhe për përcaktimin e dëmshpërblimit civil.
- Vlerësimi psiko-social i kryer nga profesionistë të certifikuar (psikologë, punonjës socialë, mjekë ligjorë) duhet të përfshijë, jo vetëm konstatimet e momentit, por edhe efektet afatgjata tek viktima, nëse kjo është e mundur sipas arritjeve shkencore përkatëse.
- Rritje e përdorimit të teknikave miqësore për dëgjimin e viktimës;
- shmangia e ballafaqimit, pasi rrit rrezikun e riviktimizimit duke siguruar një balancim të mbrojtjes së të drejtave të viktimës dhe të pandehurit.

-*Arsyetimi i vendimeve në mënyrë të plotë.*

- Vendimet të jenë të arsyetuara, të qarta e të kuptueshme.
- Arsyetimi të shpjegojë bazën ligjore të zbatuar, përfshirë aktet ndërkombëtare që referohen në vendim.
- Arsyetimi mund të zhvillojë dialogun gjyqësor me vendime të gjykatave të tjera nëse është rasti.
- Rikualifikimi i veprës penale paraqitet i arsyetuar në vendim.
- Gjykata të pasqyrojë në arsytimin e vendimit gjyqësor, argumentet për zbatimin e rrethanave lehtësuese ose rënduese.
- Kufizimi i përdorimit të rrethanave lehtësuese të papërshtatshme (si pendesa formale, mosha e re, statusi familjar, apo marrëdhëniet e normalizuara me viktimën), pasi ato bien ndesh me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së viktimave.

2. Përcaktimi i mekanizmave për ndjekjen e situatës së viktimës gjatë dhe pas përfundimit të procesit penal.

- Gjykatat marrin parasysh nevojën për rehabilitim të viktimës.
- Gjykatat vendosin për dëmshpërblim moral dhe material, nëse paraqitet padi civile në procesin penal, derisa nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor.
- Prokurori ka detyrë të përcaktojë masat për mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale (mjekësore, psikologjike, sociale, strehimore, etj.) në fazën e hetimit.
- Ka nevojë të standardizohet bashkëpunimi i Prokurorit me oficerët e policisë gjyqësore, koordinatorët e viktimave dhe të tretët që japin shërbime në këtë fushë.
- Prokurori informon viktimën për të drejtat, përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit dhe përfshin në fashikullin e dosjes kërkesëpadinë e paraqitur nga viktima në fazën e hetimeve.
- Rritet bashkëpunimi i gjykatave dhe prokurorive me mekanizmin vendor të referimit kundër dhunës ndaj grave, shërbimet sociale dhe organizatat e specializuara për ndihmë psiko-sociale, shëndetësore, mbështetje ekonomike ose strehimore dhe rikthim në shoqëri si për viktimën, ashtu edhe për autorin e veprës penale.
- Specializimi dhe rritja profesionale e avokatëve kryesisht.
- Krijimi në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë të listave të avokatëve kryesisht, me specializim përkatës në krimet seksuale, dhunën me bazë gjinore apo viktimën e mitur, duke rritur kështu mundësinë e përfaqësimit ligjor të specializuar të viktimës. Gjatë caktimit të mbrojtësit kryesisht, gjykata të ketë parasysh këto lista.
- Parashikohet krijimi i fondeve të posaçme për viktimat e dhunës seksuale, që do të siguronte mbështetje të menjëhershme.
- Parashikohet krijimi i mekanizmave ligjore për informimin e viktimës edhe pas përfundimit të procesit penal. (Drejtoria e burgjeve, Policia e Shtetit).

3. Përmirësimi i statistikave dhe monitorimit të rasteve

- Krijohen të dhëna të detajuara për viktimat e dhunës seksuale, pasojat e raportuara, masat e marra dhe për rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë përfshijnë në raportet vjetore analitike edhe mënyrën se si trajtohen viktimat gjatë dhe pas procesit penal, si dhe pasojat e dhunës seksuale në praktikë.

4. Zhvillimi i trajnimeve me fokus rritjen e ndjeshmërisë gjinore dhe psikologjike të trupës gjyqësore dhe palëve të tjera në procesin gjyqësor.

Gjyqtarët, prokurorët, avokatët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët e viktimave të marrin trajnim të vazhdueshëm në fushën e:

- dhunës me bazë gjinore dhe ndjeshmërisë ndaj traumës,
 - njohjes dhe adresimit të riviktimizimit. Kjo do të shmangte interpretimet e gabuara të sjelljes së viktimës dhe minimizimit të dhunës seksuale, duke e trajtuar atë si “konflikt mes palëve”.
 - Procedurave miqësore për viktimën, me qëllim mosrivendosjen nën stres psikologjik nga pyetjet e përsëritura, ballafaqimi me autorin apo vlerësime paragjyqësore.
 - Mbështetja psiko-sociale gjatë gjithë procesit, përfshirë fazën e apelimit, mbetet thelbësore.
- Trajnime të detyrueshme për avokatët, duke siguruar specializimin e tyre.
 - Rritja e bashkëpunimit dhe forcimi i rolit të Ndihmës Juridike Falas duke siguruar mbrojtje falas e të specializuar për viktimën e dhunës seksuale.
 - Hartimi i një Manuali për gjuhën e ndjeshme dhe mosdiskriminuese në vendimet gjyqësore, sipas standardeve të Konventës së Stambollit dhe rekomandimeve të Komitetit GREVIO.
 - Krijimi i një baze të dhënash e unifikuar e vendimeve model apo vendimeve të GJEDNJ-së, për konsultim nga gjyqtarët dhe ndihmësit ligjorë.

5: Bashkëpunimi me shoqërinë civile

- Rritja e bashkëpunimit të gjykatave me OSHC-të që sigurojnë ndihmë juridike falas të specializuar, ndihmë psiko-sociale, mbështetje ekonomike dhe rikthim në shoqëri si për viktimën ashtu edhe për autorin e veprës penale.
- Zhvillimi i fushatave për informimin e viktimave mbi të drejtat e tyre procedurale duke hartuar materiale informuese të thjeshtuara dhe të aksesueshme qoftë edhe nëpërmjet gjykatës ose prokurorisë.
- Monitorimi i praktikës gjyqësore dhe publikimi periodik i raporteve. Ndjekja e rregullt e vendimeve për krimet seksuale për të identifikuar tendencat, boshllëqet dhe progresin institucional.

- Programe edukimi për të rinjtë, prindërit dhe shkollat mbi sigurinë seksuale, raportimin, dhe shenjat e abuzimit. Bashkëpunimi me gjykatat për këtë qëllim.

LITERATURA:

1. Raport. Gjykimi i krimeve seksuale dhe mbrojtja e viktimës në procesin penal. *Gjetje nga monitorimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave të Shkallës së Parë, Lezhë e Sarandë (2020–2024)*. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, Nëntor 2025.
2. Aurela Anastasi, & Agustela Nini-Pavli. (2024). Critical Analysis of Albanian Criminal Legislation on Protection from Sexual Abuse. *Krytyka Prawa. Niezależne Studia Nad Prawem*, 16(2), 174–191. <https://doi.org/10.7206/kp.2080-1084.684>
3. Studim. *Përmirësimi i Legjislacionit Shqiptar në Fushën e Barazisë Gjinore*, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Janar 2023, https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf